



Prishtinë:16.02.2022
Kodi i ZRRE-së :V_1500_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,
Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nr. 05/L-084;
- Nenin 28 paragrafi 5 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Vendimin e Bordit të ZRRE-së: V_1489_2022 të datës 08.02.2022
- Kërkesën e datës 16.02.2022 për aprovimin e faturës nga Furnizuesi me Shërbim Universal - KESCO

në mbledhjen e mbajtur më datë 16 shkurt 2022 e nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** kërkesa e Furnizuesit me Shërbim Universal - KESCO për aprovimin e faturës së energjisë elektrike, e cila do të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës me plotësim/ndryshimet e kërkuara.

Arsyetim

- ZRRE me datë 16.02.2022 ka pranuar nga KESCO kërkesën për aprovimin e dizajnit të ri të faturës për konsumatorët e cila do të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës bazuar në vendimin e Bordit të ZRRE-së nr. V_1489_2022 të datës 08.02.2022.
- Kjo kërkesë e KESCO-s ka ardhur si rrjedhojë e aprovimit të tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me te drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal dhe ndryshimit të strukturës tarifore nga Bordi i ZRRE-së me vendimin V_1489_2022 të datës 08.02.2022, për konsumatorët shtëpiak, grupi tarifore 5(4/02) dhe 6(4/01) me limitet e konsumit 0-800 kWh dhe >800 kWh.
- ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e Furnizuesit me Shërbim Universal -KESCO dhe vlerëson se dizajni i ri i faturës i plotëson kërkesat e dalura nga vendimi i Bordit të ZRRE-së nr. V_1489_2022 të datës 08.02.2022.
- Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- Furnizuesit me Shërbim Universal KESCO,
- Arkivit të ZRRE-së.